



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:294516

Datë: 26.09.2024

Numri i dokumentit: 06215572

Ac.nr.8273/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Enes Mehmeti dhe Halide Reka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.A. nga Vushtrria, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.U., avokat nga Vushtrria, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson G.B., me bazë juridike kompensim i pagës jubilarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4661/2019 të datës 10.05.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 25.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pa bazuar ankesa e të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), me seli në Prishtinë, ndërsa pika I e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4661/2019 i datës 10.05.2022, VËRTETOHET.

II. Pika II e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4661/2019 të datës 10.05.2022, mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.4661/2019 të datës 10.05.2022, në pikën një të dispozitivit ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit B.A. nga Vushtrria, dhe ka detyruar të paditurën Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) në Prishtinë, që paditësit në emër të tri pagave për shpërblim jubilar t'ia paguaj shumën prej 1,548.00 euro, së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8%, e cila do të llogaritet nga data e nxjerrjes së aktgjykimit prej datës 10.05.2022 e gjerë në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim. Në pikën dy, refuzuar si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë mbi shumat e gjykuara si në pikën I (një), të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë në shumë prej 467.01 euro.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë e përfaqësuesi e të paditurës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar paditësi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 (pika d) dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësi me datën 20.12.2019, pranë Gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës lidhur me pagesën e shpërblimit jubilar, duke kërkuar që ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia njoh të drejtën për pagesën e tri pagave jubilarë në shumë prej 2,015.01 euro me kamatë prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës. E paditura me anë të përgjigjes në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar duke propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimin të atakuar, duke u bazuar në nenin 87 dhe 55 të Ligjit të Punës, nenit 245 dhe nenin 382 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë pjesërisht është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë për të cilën Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i palës ankuese për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimin është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimin. Në arsyetim të aktgjykimin po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimin janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata e Apelit nuk i ka pranuar pretendimet e ankuesit për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të administruara, me të drejtë ka vërtetuar faktin vendimtar se paditësi i ka plotësuar kushtet e parapara me Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, ngase i njëjti ka përvojë pune prej 35 vite 9 muaj e 9 ditë, ky fakt vërtetohet me kartelën e punëtorit nr. 4514. Në bazë të nenit 52, paragrafi 1.3 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës e datës 18.03.2014 e cila është në fuqi nga data 01.01.2015 është paraparë: *I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij, ndërsa paragrafi 2 i kësaj marrëveshje parasheh: Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë.* Në rastin konkret nuk ishte kontestuese fakti relevant se punëdhënësi i fundit është e paditura edhe përkundër asaj se me vendimet e saja është zotuar ti përmbush detyrimet, megjithatë e njëjta nuk ka vepruar sipas nenit 52, par.3 të MPKK e cila dispozitë parasheh: *Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf.*

Gjykata e Apelit me kujdesin e shtuar e ka analizuar pretendimin ankimor të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesëpadisë dhe erdh në përfundim se një pretendim i tillë është ia pa qëndrueshëm, për arsye se paditësit e drejta për të kërkuar pagat apo shpërblimet jubilarë i është krijuar me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive me datë 01.01.2015, kur paditësi ka qenë në marrëdhënie pune me të paditurën, ndërsa paditësi padinë e ka paraqitur me datën 15.09.2020, që nënkupton se padia është paraqitur pas afatit 3 vjeçar të paraparë me nenin 87 të Ligjit të Punës, mirëpo në rastin konkret kemi ndërprerje të afatit të parashkrimit, ngase nuk ishte kontestuese fakti relevant se e paditura me vendimet e saja nr.2244 e datës 10.04.2019 dhe nr.8261 të datës 23.08.2019, ua ka njohur të punësuarve të saj shpërblimin jubilar sipas kritereve të përcaktuara dhe atë për periudhën kohore nga data 01.01.2015 e deri me datën 31.12.2019, respektivisht e paditura me këto vendime e ka pohuar detyrimin financiar që e ka ndaj paditësit sipas MPKK-së. Sipas nenit 368 par.1 të LMD-së parashihet: *Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin,* ndërsa me nenin 373 par. 2 të po këtij ligji parasheh: *Parashkrimi i ndërprerë me anë të pranimit (pohimit) nga ana e debitorit fillon të rrjedhë përsëri nga pranimi (pohimi).* Nuk qëndron as pretendimi tjetër i të paditurës se paditësit nuk i takon kjo e drejt, me arsye se vitin jubilar e ka arritur në kohën kur nuk ka qenë në fuqi MPKK, por ky pretendim ankimor vlerësohet si përpjeke e të paditurës për t'iu shmangur përmbushjes së detyrimit, sepse paditësi me rastin e arritjes së vitit jubilar nuk ka pasur bazë juridike që një të drejtë të tillë të realizon në atë kohë, respektivisht paditësit kjo e drejtë i është krijuar me rastin e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive me datë 01.01.2015.

Gjykata e Apelit po ashtu vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se gabimisht është zbatuar e drejta materiale, për arsye se dispozita e nenit 245 i LMD-së, parasheh se kreditori në marrëdhënie detyimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, si dhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për shkak të mospërmbushjes së detyrimit apo vonesës në përmbushje, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi. Andaj në kuptim të këtyre dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë.

Meqë, aktgjykimi i ankimuar nuk është goditur me ankesë në pikën II të dispozitivit të tij nga pala me interes juridik, gjykata e shkallës së dytë, duke iu përmbajtur kufizimit ligjor të mjetit juridik (kufijtë e ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar), sipas nenit 194 të LPK-së, këtë pikë të aktgjykimit të ankimuar nuk e shqyrtoi fare.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, që do të ndikonte në ligjshmërinë e aktgjykimit, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.8273/2022, me datë 25.09.2024

Kryetare e kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.